



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 tetor 2016
Nr. ref.:RK982/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI142/15

Parashtrues

Habib Makiqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 231/2015,
të 1 shtatorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Habib Makiqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Reznik, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 231/2015, të 1 shtatorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 231/2015, të 1 shtatorit 2015.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
5. Në thelb, parashtruesi i kërkesës kryesisht ankohet në lidhje me mospërputhjen e pretenduar të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 1 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
8. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu (gjyqtarë).
9. Më 29 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
10. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton që parashtruesi ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës – Distrikti i Mitrovicës (në tekstin e mëtejshëm: punëdhënësi) për një periudhë të pacaktuar kohore.
12. Më 25 gusht 2010, me auditimin e brendshëm të punëdhënësit ishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kishte keqpërdorur njehsorin elektrik të regjistruar në emrin e tij.

13. Më 18 tetor 2010, Menaxheri i Distriktit të punëdhënësit njoftoi (Njoftimi nr. 409) parashtruesin e kërkesës se kontrata e tij e punës ishte ndërprerë. Kontrata e punës ishte ndërprerë me arsyetimin se parashtruesi kishte kryer shkelje të rënda - vjedhjen e pronës ose të pronësisë së KEK-ut, duke përfshirë edhe vjedhjen e energjisë elektrike të paraparë me nenin 8.14, pika (a) të Rregullores nr. 3 për operacionet e distrikteve të KEK-ut.
14. Më 22 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kundërshtim te Drejtori i Divizionit të Punëdhënësit kundër njoftimit të lartcekur për shkëputjen e kontratës së tij të punës.
15. Më 29 tetor 2010, drejtori i distriktit i punëdhënësit (Vendimi nr. 5473) hodhi poshtë kundërshtimin e parashtruesit si të pabazuar.
16. Parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri, duke pretenduar kthim në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat e punës.
17. Më 13 prill 2012, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 460/2010, konstatoi si në vijim:

“APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Habib Makiqi dhe OBLIGOHET e paditura KEK në Prishtinë që paditësin ta kthej në punë dhe detyrat e tij të punës- elektrikist në kujdestari në Distriktin e Mitrovicës, apo në punë dhe detyrat e punës që përkojnë me përgatitjen e tij profesionale dhe aftësitë e tij të fituara në punë me të gjitha të drejtat e punës - edhe pagesë e të ardhurave personale nga dita e ndërprerjes së punës me dt. 18.10.2010 e deri në ditën e kthimit të tij në punë”.

18. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Komunale, *inter alia*, arsyetoi se: (i) parashtruesi nuk ishte njoftuar me shkrim për shkëputjen e marrëdhënies së tij të punës siç kërkohet me ligjin në fuqi, dhe (ii) punëdhënësi nuk ka paraqitur një vendim përfundimtar të gjykatës penale që konfirmon se parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes.
19. Më 1 janar 2013, hyri në fuqi Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, i cili parasheh që juridiksioni i gjykatave komunale dhe të qarkut do të ushtrohet nga gjykatat themelore dhe nga Gjykata e Apelit në territorin e Republikës së Kosovës.
20. Nga dokumentet e dorëzuara del se punëdhënësi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila e ktheu rastin për rishqyrtim në Gjykatën Themelore, në Vushtrri.
21. Më 23 prill 2014, Gjykata Themelore në Vushtrri, me Aktgjykimin, C. nr. 17/14, konstatoi si më poshtë:

“I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Habib Makiqi si e themeltë.

II. ANULOHET, Njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës nr. 409 e datës 18/10/2010 dhe Vendimi i të paditurës KEK nr.5473 e datës 29/10/2010, si të kundërligjshme.

III. DETYROHET e paditura KEK-u në Prishtinë, që paditësin Habib Makiqi ta kthej në punë dhe në detyrat e tij të punës-elektricitist në kujdestari në distriktin e Mitrovicës apo në një vend tjetër që përkohë me përgatitjet e tij profesionale.

IV. URDHROHET e paditura që t'ia kompenzon të gjitha pagat sipas kontratës së punës dhe përfitimet tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm e deri në ditën e kthimit të tij në punë”.

22. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Themelore, *inter alia*, arsyetoi se vendimet e punëdhënësit ishin në kundërshtim me ligjin për shkak të moskryerjes së procedurës disiplinore të paraparë me ligj – dhe si pasojë e kësaj – parashtruesi i kërkesës nuk ishte marrë në pyetje nga organi disiplinor dhe nuk i ishte lejuar mbrojtja në bazë të zgjedhjes së tij.
23. Punëdhënësi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Punëdhënësi propozoi që Aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
24. Më 4 maj 2015, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin CA. nr. 2044/2014, e refuzoi ankesën e punëdhënësit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e aprovoi arsyetimin e Gjykatës Themelore duke shtuar, *inter alia*, se kontrata e punës së punonjësit nuk mund të shkëputet vetëm në bazë të vendimit të menaxherit pa zbatimin e procedurave disiplinore.
25. Megjithatë, sa i përket zhvillimit të procedurës disiplinore, Gjykata e Apelit gjithashtu, deklaroi:

“Pas gjetjes se komisionit të përmendur, paditësi është ftuar më 18.10.2010 në mbledhje me menaxherin, ku iu ka komunikuar se kontrata e punës është shkëputur për shkak të shkeljes së rëndë të obligimeve të punës. Në të njëjtën ditë është nxjerrë edhe lajmërimi me shkrim. Në lajmërimin për shkëputjen e kontratës paditësi ka ushtruar ankesë e cila iu ka refuzuar”.

26. Punëdhënësi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Punëdhënësi propozoi që aktgjykimet e gjykatave të shkallës së ulët të ndryshohen, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar.
27. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin, Rev. nr. 231/2015, e aprovoi revizionin e punëdhënësit dhe e ndryshoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore, përkatësisht të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme

shpjegoi, *inter alia*, se punëdhënësi e ka zhvilluar dhe e ka respektuar procedurën disiplinore – siç kërkohet me ligj – dhe se, parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia e parashtrimi të kundërshtimit të tij pranë organit kompetent të punëdhënësit.

28. Në pjesën relevante të aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, thuhet:

“Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët drejtë dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, por gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për të cilin shkak u deshtë të pranohet revizioni i të paditurës, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se vendimi i të paditurës nr.409 datë 18.10.2010 për shkëputjen e kontratës së punës dhe vendimi i Drejtorit të divizionit të rrjetit nr. 5473 datë 29.10.2010, me të cilin është refuzuar sj i pabazë kundërshtimi nr. 426 datë 22.10.2010, janë të ligjshme, ngase me provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës del se e paditura para marrjes së vendimeve të kontestuara ka udhëhequr procedurën në kuptim të dispozitave të nenit 11.5 (a) dhe (b) të Ligjit themelor të punës në Kosovë - Rregullorja nr. 2001/27, si dhe nenin 8.4 (a) dhe (b) të Rregullores nr. III për operacionet për Distriktin e KEK-ut, sipas të cilave është paraparë se në rast kur zbatohet neni 11.2, punëdhënësi duhet të mbajë një takim me punonjësin me ç'rast ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punonjësi është anëtar i ndonjë sindikate, ka të drejtë që në takim të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës.

Në rastin konkret e paditura ka vepruar në tërësi në kuptim të dispozitave të lartcekura, kur paditësit me vendimet e kundërshtuara ia shkëputur kontratën e punës për shkak të sjelljes së rëndë - të keqe të parapara me nenin 11.3 (b) dhe (d) të Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë si dhe nenit 8.14 (a) të Rregullores për Operacionet e Distrikteve të KEK-ut, për të cilën shkelje e paditura i ka shqiptuar masën disiplinore - shkëputja e kontratës së punës”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesioneve] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: “Në rastin tim, dy shkallë kanë vendosur duke aprovuar kërkesëpadinë time, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Supreme është refuzuar kërkesëpadia ime. Për të njëjtin rast, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. No. 62/2014 të 20.03.2014, ka pranuar revizionin e paditësit X, dhe ka kthyer në punë. Është absurde Gj. Supreme merr vendime të ndryshme për raste të njëjta”.

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Gjykata Supreme e Kosovës gjatë shqyrtimit të rastit, i ka munguar paanshmëria përkatësisht edhe pse Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit e aprovojnë kërkesëpadinë e paditësit Habib Makiqi, e njëjta sikur të ishte e drejtuar nga ndonjë direktiv vendos të kundërtën dhe vendimi, përkundër provave të parashtruara dhe të sqaruara në vendimet e shkallës së parë dhe të dytë, në një mënyrë (qëllimisht) është i padrejtë dhe zbeh besimin e qytetarëve në zbatimin e drejtësisë dhe shtetin ligjor."*

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

34. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

35. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, që parasheh:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se::

...

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

36. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se: *"Gjykatës Supreme të Kosovës i ka munguar paanshmëria ... Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar si të themelt revizionin e paditësit X dhe e ktheu atë në punë. Është absurde se si kemi vendime të ndryshme nga Gjykata për raste të njëjta".*

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

38. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës nuk akordon një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë, sepse dështimi për të mbajtur një qëndrim dinamik dhe progresiv do të rrezikonte pengimin e reformës apo përmirësimit (Shih rastin *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, kërkesa nr. 13279/05, [DHM], Aktgjykimi i 20 tetorit 2011, paragrafi 58).
39. Në parim nuk është roli i Gjykatës, madje edhe në rastet në shikim të parë të krahasueshme ose të ndërlidhura, që të krahasojë vendimet e ndryshme të nxjerra nga gjykatat e rregullta, pavarësia e të cilave duhet të respektohet. Divergjencat e mundshme në praktikën gjyqësore janë pasojë e natyrshme e çdo sistemi juridik që bazohet në një rrjet të gjykatave të faktit dhe të apelit me kompetencë në fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjenca të tilla mund të lindin edhe në të njëjtën gjykatë. Kjo nuk mund vetvetiu të konsiderohet në kundërshtim me Konventën (Shih, rastin *Santos Pinto kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 39005/04, GJEDNJ, Vendim i 20 majit 2008, paragrafi 41). Përveç kësaj, nuk mund të ketë “divergjenca”, aty ku situatat faktike në fjalë janë objektivisht të ndryshme (shih rastin *Uçar kundër Turqisë*, kërkesa nr. 12960/05, GJEDNJ, Vendimi i 29 shtatorit 2009).
40. Për më tepër, në këtë pikë, Gjykata vëren se mospërputhja e praktikës gjyqësore duhet të jetë e thellë dhe e qëndrueshme dhe duhet të ndikojë në një numër të madh të njerëzve dhe jo të jetë një rast i izoluar (Shih rasti *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. 34796/06 dhe 63 raste të tjera, GJEDNJ, Aktgjykimi i 10 majit 2012, paragrafi 38).
41. Prandaj, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në kërkesë që sugjeron se mospërputhja e pretenduar e praktikës gjyqësore ishte e thellë dhe e qëndrueshme, ose se ajo kishte ndikuar në një numër të madh njerëzish, apo nëse është fare çështje e një rasti të izoluar.
42. Sa i përket shkeljeve që pretendohet të jenë bërë gjatë procedurës disiplinore pranë organeve kompetente të punëdhënësit, Gjykata dëshiron të theksojë se drejtësia e procedurave vlerësohet gjithmonë duke shqyrtuar ato në tërësinë e tyre, ashtu që një parregullsi e izoluar mund të mos jetë e mjaftueshme që ta nxjerrë të padrejtë procedurën në tërësi (Shih rasti i *Miroļubovs dhe të tjerët kundër Letonisë*, § 103).
43. Neni 31 i Kushtetutës nuk garanton rezultat të favorshëm në rastin e dikujt, dhe as nuk lejon që Gjykata ta vë në pyetje drejtësinë materiale të rezultatit të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb.
44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtuesit i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kundërshtimit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të

rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

45. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
46. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
47. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
48. Në fund, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vetëm numëron dhe në përgjithësi përshkruan përmbajtjen e dispozitave kushtetuese pa dëshmuar saktësisht, se si janë shkelur ato dispozita në rastin e tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
49. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet e rastit nuk tregojnë se Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.
50. Në bazë të vlerësimeve të mësipërme, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi